



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo**

Qeveria - Vlada - Government

**MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING**

AGJENCIA PËR MBROJTJEN E
MJEDISIT TE KOSOVËS

KOSOVSKA AGENCIJA
ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO ENVIRONMENTAL
PROTECTION AGENCY

INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS

ELABORAT:

**STUDIMI PËR ARSYESHMËRINË PROFESIONALE PËR MARRJEN NË MBROJTJE
TË VLERËS SË NATYRËS: KOMPLEKSI I TRUNGJEVE TE QARRIT (*Quercus
cerris*) NË BINÇË TË VITISË SI MONUMENT I NATYRËS**

**Prishtinë,
Nëntor 2019**

Në përgatitjen e këtij elaborati morrën pjesë:

Udhëheqës i punëve:

Dr.sc. Qenan Maxhuni – zyrtar për biodiversitet

Hulumtimi në terren:

Dr. sc. Qenan Maxhuni – zyrtar për biodiversitet

Dr. sc. Sami Behrami – zyrtar për zona të mbrojtura

Nexhmije Kamberi – zyrtare për florë

Bashkëpunëtor të jashtëm:

MSc. Alban Sokoli, udhëheqës i Sektorit për Mjedis, DUPMM, K.K. Viti

Zymrije Salihu – zyrtare për mjedis, DUPMM, K.K. Viti

Vesa Jaha – praktikante në IKMN

Parathënie

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës është trashëgimtar i Entit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës i themeluar me vendimin mbi ndarjen e Seksionit për Mbrojtjen e Natyrës nga Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, (GZ. 42/74) dhe ka vazhduar punën me të njëjtin emër sipas ligjit mbi Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (GZ. 15/81).

Në vitin 1988 Kuvendi i Kosovës nxjerrë ligjin për Mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave natyrore dhe të vlerave të krijuara me punë të ambientit të njeriut ("GZK"39/88) ku në nenin 78 paragrafi 2 të këtij ligji është përcaktuar veprimtaria e Entit. Në bazë të këtij ligji një vit më vonë Kuvendi i Kosovës nxjerrë Ligjin për Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit ("GZK"nr. 38/89).

Pas luftës në Kosovë, në vitin 2000 ish Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit regjistrohet në Administratën e Përkohshme civile të OKB-se me emërtim "Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ambientit të Kosovës".

Nga maji i vitit 2000, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës ka vepruar në kuadër të Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit, ndërsa pas zgjedhjeve të përgjithshme (2001) dhe formimit të organeve qeverisëse të Kosovës, vepron në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (Rreg. 2001/19 dhe 2002/5).

Aktualisht IKMN, vepron në kuadër të Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit e cila është themeluar duke u bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit. (Rreg. 2003/9).

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës¹ në kuadër të veprimtarisë së vetë kryen punët profesionale në mbrojtjen e natyrës që kanë të bëjnë me:

- mbledhjen dhe përpunimin e shënimeve lidhur me mbrojtjen e natyrës;
- monitorimin e gjendjes së larmisë biologjike dhe peizazhore dhe propozon masat për mbrojtjen e tyre;

¹ Ligji për Mbrojtjen e Natyrës nr. 03/L-233

- hartimin e bazave afatgjata profesionale të mbrojtjes për llojet e bimëve, kërpudhave dhe shtazëve, tipave të vendbanimeve, ekosistemeve dhe peizazheve;
- përgatitjen e bazave profesionale për mbrojtjen dhe ruajtjen e pjesëve të natyrës, përkatësisht vlerave të natyrës;
- hartimin e bazave profesionale për nevojat e përcaktimit të kushteve për mbrojtjen e natyrës, menaxhimin me zonat e mbrojtura dhe shfrytëzimi i të mirave të natyrës;
- kryerjen e analizave statistikore dhe unifikimin e rezultateve si dhe hartimin e raportit për gjendjen dhe mbrojtjen e natyrës;
- pjesëmarrje në zbatimin e akteve ndërkombëtare në mbrojtjen e natyrës.

Gjatë verës së vitit 2005, IKMN si organ qendror për mbrojtjen e natyrës, në kuadër të aktiviteteve të tij ka bërë njohjen dhe evidentimin e vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Vitisë. Në tetor të vitit 2005 IKMN i ka propozuar Kuvendit Komunal të Vitisë Iniciativën për shpalljen e vlerave të natyrës nën mbrojtje, ndërsa K.K. i Vitisë në mbledhjen e mbajtur me 20.03.2006 ka miratuar vendimin për mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë natyrore në K. e Vitisë duke i hapur kështu rrugë procesit për hartimin e bazave profesionale për shpalljen e zonave të mbrojtura sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

Gjatë vitit 2019, IKMN ka grumbulluar të dhënat e nevojshme në terren për hartimin e bazave profesionale për vënien nën mbrojtje të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Vitisë. Me këtë rast ka përgatitur elaboratin: **Studim për arsyeshmërinë profesionale për marrjen nën mbrojtje të vlerës së natyrës Kompleksi i Trungjeve të Qarrit (*Quercus cerris*) në Binçë të Vitisë si Monument i Natyrës.**

Përmbajtja

1. Baza profesionale dhe dokumentimi për marrjen ne mbrojtje te vlerës natyrore
 - 1.1. Emërtimi i vlerës natyrore
 - 1.2. Lloji i monumentit
 - 1.3. Kategoria e mbrojtjes
 - 1.4. Klasifikimi sipas IUCN-se
 - 1.5. Pozita
 - 1.6. Kufijtë
 - 1.7. Sipërfaqja
 - 1.8. Përshkrimi i vlerës natyrore
 - 1.8.1. Karakteristikat natyrore
 - 1.8.2. Karakteristikat biologjike te llojit *Quercus cerris*
 - 1.8.3. Karakteristikat tjera
 - 1.8.4. Karakteristikat baze te vlerës se mbrojtur natyrore
 - 1.9. Shkalla e rrezikimit
 - 1.10. Historiku i Mbrojtjes
 - 1.11. Konceptet baze për mbrojtje , zhvillim dhe rregullim
 - 1.12. Organet përgjegjëse për mbrojtje
 - 1.13. Regjimi dhe masat mbrojtëse
 - 1.14. Arsyetimi i Propozimit për Kategorizim
 - 1.15. Propozimi i Kategorisë
2. Shtojcat
 - 2.1. Dokumentacioni grafik
 - 2.1.1. Harta e vlerës natyrore
 - 2.1.2. Ekstrakti nga fleteposedimi
 - 2.1.3. Kopja e Planit
 - 2.2. Dokumentacioni Fotografik
3. Referencat

**1. BAZA PROFESIONALE DHE DOKUMENTIMI PER MARRJEN NE MBROJTJE
LIGJORE TE VLERES NATYRORE**



1.1. Emërtimi i vlerës natyrore

Kompleksi i Trungjeve të Qarrit (*Quercus cerris*) në Binçë.

1.2. Lloji i monumentit

Monument natyror me karakter botanik.

(Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, (Nr. 03/L-233) Neni 14.

1.3. Kategoria e mbrojtjes

Kategoria e trete e mbrojtjes (III) – Monument i Natyrës

1. Monumenti i natyrës është pjesë ose tërësi e pjesëve të pandryshuara të natyrës së gjallë ose të vdekur i cili ka vlerë ekologjike, shkencore, estetike ose kulturo-historike dhe/ose vlera turistike.

2. Monumenti i natyrës mundet me qenë gjeologjik - paleontologjik, mineralogjik, hidrologjik, strukture gjeologjike, sediment etj, gjeomorfologjik - shpella, humnera, muret shkëmbore, hidrologjik - burime, ujë rrjedhë, ujëvarë, liqe, **botanik - ekzemplarë të rrallë ose të rëndësishëm të botës bimore për një lokalitet, lokalitet i vogël botanik ose zoologjik i rëndësishëm për vlerat e tij shkencore.**

(Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, (Nr. 03/L-233) Neni 14.

1.4. Klasifikimi sipas IUCN-së

Kategoria e tretë (III).

Monument natyror (Natural Monument / Natural Landmark)

(“Korniza për klasifikimin e zonave të mbrojtura tokësore dhe detare, IUCN, 1990)

1.5. Pozita

Monumenti natyror Kompleksi i Trungjeve të Qarrit pranë rrugës kryesore, përballë varrezave katolike të fshatit Binçë (lagjia e Shoshve), në periferi të fshatit, rreth 3 kilometra larg qytetit të Vitisë. Vendndodhja e tyre ka qenë varreza por që nuk janë përdorë që nga vitet e 50`ta.

Sipas matjeve me GPS (GPS Garmin 12 channel) trungjet ndodhen në koordinatat:

X = 0529993


Y = 4682342

Lartësia mbidetare = 547 m

1.6. Kufijtë

Sipërfaqja ku ndodhet Kompleksi i Trungjeve të Qarrit (*Quercus cerris*) në fshatin Binçë të Komunës së Vitisë gjendet në vendin e quajtur Tamnjanka në lagjen e Shushëve, përballë varrezave katolike të fshatit, në parcelën 1438-0, zona kadastrale Binçë, nr. P-70101003-01438-0, me sipërfaqe 1397m², në pronësi kuvendi Komunal i Vitisë. (Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, K. K. Viti).

Si kufi për Monumentin e Natyrës - Kompleksi i trungjeve të qarrit të merret hapësira ku gjinden trungjet së bashku me një rreze diametri prej afër 12.5 m nga ana periferike e të gjitha trungjeve.



1.7. Sipërfaqja

Sipërfaqja e Monumentit natyror përfshinë hapësirën të cilën e mbulojnë trungjet. Propozohet për mbrojtje sipërfaqja **prej 13.97 ari**.

1.8 Përshkrimi i vlerave

1.8.1 Karakteristikat natyrore

Kompleksi i Trungjeve të Qarrit (*Quercus cerris*), që janë gjithsej 8 sosh, ndodhet në dalje të fshatit rruga për Samakovë. Trungjet kanë vlera natyrore dhe shkencore. Trashësia e trungjeve, vjetërsia e tyre, përmasat e kurorës janë vlera të rralla natyrore të këtij monumendi.

Vlenë të përmendet se përveç vjetërsisë së lisave, njëri prej tyre shquhet edhe me një karakteristikë tjetër të veçantë natyrore në të cilin është zhvilluar një bimë tjetër drunore si gjysmë – parazit që i takon llojit *Viscum sp.*

Trungjet i kanë këto karakteristika dendrometrike:

Lartësia e kërcellit rreth 35 m
Perimetri i trungut prej 1.60 – 3.60 m
Diametri i kurorës..... rreth 20 – 30 m
Vjetërsia e trungut mbi 150 vite.

Gjendja e natyrore e trungjeve është e mirë.

1.8.2. Karakteristikat biologjike të llojit

Karakteristikat e llojit *Quercus cerris*:

Dru që zakonisht rritet në lartësi prej 25-35 m, dhe që haset gati gjithkund dhe me shumice në kodra të veshura me esenca pyjore gjethegjera në lartësi mbidetare deri në 1400 m.

Lëvorja- e murrme në të errët e qarë thellë për se gjati.

Kurora e hapur dhe në forme vezake .

Degët e reje të ashpra me qime të murrme ngjyre ndryshku.

Sythet me madhësi 5-12 mm, në formë të ngjashme me vezën të rrethuar prej ndajgjethezave .

Gjethet- gjatore –vezake të përmbysët, të rrumbulluara ose gati si zemër në bazë , me 4-7 palë vriguj ose dhembë , përsipër gati të shogëta , disi të ashpra dhe pa shkëlqim , me ngjyrë të blerta të çelët, me madhësi 5-10 x 3-5 cm tek drunjtë e vjetër edhe me të mëdha me bishtak 8-15 mm, bien në vjeshtë.

Lulet mashkullore me 4-5 theke pushlore.

Frytet piqen vitin e dytë , të vetmuar ose dy deri katër në një bosht , gati pa bisht , gishtja me melunga të holla, të hapura me maje të përthyer ose të drejtë dhe shumë a pak të përdredhura.

Lendet kanë madhësi 20-40 x 12-22 mm, të cunguara ose majengrena me një thumb në mes .

Lulëzimi –prill-maj

Frytet-shtator –tëtor .

Përdorimi- Druri përdoret në ndërtimtari , vegla e orendi bujqësore si dhe për djegie.

1.8.3. Karakteristikat tjera

Përveç vlerave natyrore trungjet kanë edhe vlera tjera të rëndësishme si vlera estetike, dekorative dhe turistike.

Madhësia, pamja estetike dhe dekorative i bëjnë këto trungje objekte shumë atraktive për vizitorët.

1.8.4. Karakteristikat bazë të vlerës së mbrojtur natyrore

Kompleksi i Trungjeve te Qarrit në Binçë është me vlera te rralla të këtij lloji që mund të gjendet në këtë rajon. Vjetërsia, vitaliteti dhe përmasat e kërcellit dhe kurorës i bëjnë këto trungje monument me vlera te rralla natyrore, shkencore dhe turistike.

Duke marre për baze këto karakteristika këto trungje propozohen për mbrojtje si Monument i Natyrës me karakter botanik.

1.9. Shkalla e rrezikimit

Në afërsi të trungjeve nuk ka ndonjë burim te ndotjes që do të mund ta rrezikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë atë. Gjendja aktuale natyrore e trungjeve është e mirë.

1.10. Historiku i mbrojtjes

Gjate verës së vitit 2005 IKMN, gjate njohjes dhe evidentimit të vlerave natyrore në Komunën e Vitisë e ka evidentuar Trungun e Bungbutës në Zhiti si monument me vlera te rralla natyrore. Në tetor të vitit 2005 IKMN i ka propozuar Kuvendit Komunal të Vitisë Iniciativën për shpalljen e vlerave të natyrës nën mbrojtje, ndërsa K.K. i Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 20.03.2006 ka miratuar vendimin për mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë natyrore në K. e Vitisë duke i hapur kështu rrugë procesit për hartimin e bazave profesionale për shpalljen e zonave të mbrojtura sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

Gjate vitit 2019, IKMN ka grumbulluar të dhënat e nevojshme në terren për hartimin e bazës profesionale për vënien nën mbrojtje të këtij monumendi të natyrës.

1.11. Konceptet baze për mbrojtje , zhvillim dhe rregullim

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233) Neni 19. paragrafi 3, Monumentet e natyrës i shpallë kuvendi i komunës në territorin e të cilë gjendet, pas marrjes paraprake të pëlqimit nga Ministria.

1.12. Organet përgjegjëse për mbrojtje

(Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës; Nenit 143 paragrafi 1)

1. Punët administrative dhe profesionale në mbrojtjen e natyrës i kryen Ministria, përveç atyre punëve të cilat me këtë ligj ose ligj tjetër ju kanë besuar organit kompetent drejtues, Institutit ose komunës.
2. Komunat në pajtim me këtë ligj, Strategjinë, programin e mbrojtjes së natyrës dhe dokumentet e rregullimit hapësinor janë të detyruara që të:
 - 2.1. kujdesen për ruajtjen e larmisë biologjike dhe peizazhore për territorin e vet;
 - 2.2. shpallin zonat e mbrojtura për të cilat janë kompetente;
 - 2.3. sigurojnë kushtet për mbrojtjen dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura për të cilat janë kompetente;
 - 2.4. marrin pjesë në procedurën e shpalljes të zonave të mbrojtura të cilat i shpallë Qeveria ose Kuvendi;
 - 2.5. marrin pjesë në hartimin e planeve të menaxhimit me zonat e mbrojtura për të cilat janë kompetente;
 - 2.6. kujdesen për promovimin e mbrojtjes së natyrës dhe japin mbështetje dhe kujdesen për shoqatat, veprimtaria e të cilave është mbrojtja e natyrës;
 - 2.7. përcjellin gjendjen e ruajtjes së natyrës dhe për atë Ministrisë dhe Institutit i paraqesin raport;
 - 2.8. mbajnë regjistrat për shënimet të rëndësishme për mbrojtjen e natyrës;
 - 2.9. informojnë publikun për gjendjen e natyrës në territorin e vetë dhe për masat e ndërmarra për mbrojtjen dhe ruajtjen e sajë;
 - 2.10. ofrojnë ndihmë profesionale dhe ndihmë tjetër organeve të pushtetit lokal në mbrojtjen e natyrës në territorin e vetë
 - 2.11. kryejnë dhe punë të tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe aktet nën ligjore të nxjerra prej tij.

1.12. Regjimi dhe masat e mbrojtjes

Kompleksi i Trungjeve të Qarrit (*Quercus cerris*) në Binçë të Vitisë i takojnë kategorisë së tretë (III) sipas IUCN-së si Monument i Natyrës. Për ruajtjen dhe përparimin e këtij monumendi të natyrës duhet respektuar këto masa mbrojtëse:

Ndalohet:

- Prerja e trungjeve, thyerja e degëve, mbledhja e gjetheve apo frutave, kositja e barit si dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme natyrore,
- Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur,
- Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur,
- Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur,
- Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur,
- Punimi (lëvrimi, shfrytëzimi) i tokës në sipërfaqen e mbrojtur dhe
- Aktivitetet tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të monumentit.

Lejohet:

- Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

1.13. Arsyetimi i propozimit për kategorizim

Propozimi për marrjen nën mbrojtje ligjore të Kompleksit të Trungjeve të Qarrit (*Quercus cerris*) në Binçë bazohet në vlerat natyrore të këtyre trungjeve. Trungjet janë shumë karakteristike për nga pamja estetike, trashësia, vjetërsia, vitaliteti dhe pozita shumë e mirë.

Duke u bazuar në faktet e lartpërmendura mund të përfundojmë se Kompleksi i trungjeve të qarrit në Binçë i plotëson kushtet të merret nën mbrojtje ligjore si Monument Natyror me karakter botanik.

1.14. Propozimi i kategorisë


Në bazë të nenit 19. të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, (Nr. 03/L-233), **Instituti Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës propozon që Monumenti i natyrës i karakterit botanik Kompleksi i Trungjeve të Qarrit (*Quercus cerris*) të merret nën mbrojtje në kategorinë e tretë (III) si zonë e mbrojtur kryesisht për qëllime të konservimit të karakteristikave specifike natyrore.**

2. SHTOJCA



2.1. Dokumentacioni Grafik

2.1. 1. Harta e monumentit të natyrës



2.1.2. Ekstrakt nga fletë posedimi

Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MEDIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR / MINISTARSTVO SREDNE I PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70101003-01438-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 2736/2019
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vrene izdavanja / Date and time of submission: 19.11.2019 - 13:59
Komuna / Opština / Municipality: Viti / Vitha / Vrh
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: BINÇE / BINAC / BINÇE

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-70101003-01438-0	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	U/R	1397			

A1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivalište - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostni adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
TAMNJANKA MUSLIMANSKO G. / TAMNJANKA MUSLIMANSKO G.		TAMNJANKA MUSLIMANSKO G.		

Printuar nga / Odlumpun od / Printed by: Nesha Xhejli [P-70101003-01438-0]

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Responsible Person

1 / 2



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcesës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcesës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klase Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m ²) (m ²) (m ²)
1	Shërbimet Publike/Javne Usluge/Public Services	Vareze/Groblje/cemetery		1397

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licen broj ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhurnuar Azurirano Updated
Posedim individual / Indivudualna Drzavina / single possessor	P.SH.KUVENDI KOMUNAL VTI	KCID0100882	VITI / VITINA / VITI /		VITINA	1/1		

2.1.3. Kopje plani



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VITI
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Binçë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m2
P-70101003-01438-0	Parcelë / Parcela / Parcel	1397,0





Shkalla/Razmera/Scale: 1:642

2736/2019

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 19.11.2019

Koha/ Vreme/ Time: 02:03:04

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:



Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture: _____

2.2. Dokumentacioni fotografik



Quercus cerris



Lenda e *Quercus cerris*



Prania e veshtullës (*Viscum sp.*) në njërin prej trungjeve

Referencat:

- **Qosja Xh. (red.)** (1988): Flora e Shqipërisë 2, ASH e RPSSH – QKB, Tiranë.
- **Pr. Dr. Perikli Qiriazhi, Dr. Ferdinand Begu** (1999), Monumentet e Natyrës së Shqipërisë, Tirane.
- **Dr. Behxhet Mustafa , Dr. Esat Hoxha** (2003): Biodiversiteti dhe Zonat e Mbrojtura, Universiteti i Prishtinës, Prishtine
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, (Nr. 03/L-233)
- Dokumentacioni nga arkivi i IKMN-se
- Dokumentacioni nga Shërbimi Kadastral i KK Vitisë
- Harta topografike e Kosovës 1 : 25000

Përfundim

Kjo arsyeshmeri profesionale e hartuar nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës paraqet vetëm një pjese te punës profesionale të këtij institucioni në lëmin e mbrojtjes se natyrës. IKMN do të vazhdojë edhe më tutje të angazhohet në njohjen dhe evidentimin e vlerave te natyrës, në marrjen nën mbrojtje të vlerave të veçanta natyrore, në monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes së zonave të mbrojtura në territorin e Komunës suaj si dhe në dhënien e mendimeve profesionale në lëmin e mbrojtjes se natyrës.

IKMN-ja do te jete gjithmonë e hapur për bashkëpunim edhe për të gjitha çështjet tjera me interes të mbrojtjes së natyrës dhe vlerave të saj.

Me kënaqësi do të pranojmë çdo sugjerim, vërejtje apo këshillë nga ana juaj lidhur me këtë elaborat duke ju sugjeruar që të merrni masa ligjore për mbrojtjen e këtyre vlerave natyrore.

Ju falënderojmë sinqerisht për bashkëpunimin e ofruar gjatë realizimit të punëve në terren dhe në sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës

Rr. L. Haradinaj, ish Rilindja, kati XIV nr. 1403/A
10 000 Prishtine, KOSOVE;
Tel. 038/ 200 33 236
<http://ammk-rks.net/?page=1,118>